



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:064260
Datë: 18.07.2022
Numri i dokumentit: 03240348

C.nr.369/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala me bashkëpunëtorin profesional Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve A. G., A. Ll., A. Z., B. T. dhe B. T., që të gjitha nga Gjakova, të cilat me autorizim i përfaqëson i autorizuari Arbër Guta, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për kompensimin e shtesave mujore mbi pagën bazë dhe atë në vlerë të kontestit 3,000.00 euro, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur, në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, me datë 24 qershor 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësve A. G., A. Ll., A. Z., B. T. dhe B. h T., që të gjitha nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, që paditësve të lartcekura, t’ua paguajë shumën si vijon:

- Paditëses A. G., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajit Korrik 2020, Gusht 2020, Shator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i’a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00 euro.
- Paditëses A. Ll., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajit Korrik 2020, Gusht 2020, Shator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i’a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00 euro.
- Paditëses A. Z., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajit Korrik 2020, Gusht 2020, Shator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i’a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00 euro .
- Paditëses B. T., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajit Korrik 2020, Gusht 2020, Shator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i’a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00. euro.

- Paditëses B. T., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajit Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i'a paguaj shumën e përgjithshme prej 300.00 euro.

e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit për secilën paditëse, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (01.04.2021) deri në pagesën definitive të detyrimit, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar në ligj pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses B. T. nga Gjakova, mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë që në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajit Korrik 2020, Gusht 2020 dhe Shtator 2020 të i'a paguaj shumën prej 300.00.€.

III. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësve të iu paguajë shumën prej 1,163.20. euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset A. G., A. Ll., A. Z., B. T. dhe B. T., që të gjitha nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tyre Arbër Guta, avokat në Gjakovë, në këtë gjykatë me datë 01.04.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, për kompensimin e shtesave mujore mbi pagën bazë, duke theksuar se të gjithë paditësit përmes kompanisë kontraktuese “. . . sh.p.k.” janë të punësuar pranë Spitalit “Isa Grezda” në Gjakovë, në cilësinë e hixhienistëve. Të njëjtit gjatë tërë kohës së pandemisë kanë qenë në “vijën e parë të frontit” në luftën ndaj pandemisë Covid-19, duke u ballafaquar çdo ditë me pacientë të infektuar e të cilët janë për shërim në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë. I autorizuari i paditësit në fjalën e dhënë në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 18/38 i datës 30.10.2020, është zbatuar për të gjitha kategoritë e tjera përpos kategorisë ku bëjnë pjesë paditësit pra stafit mbështetës. Tutje e ka kundërshtuar përgjigjen në padi të të paditurës nga se e njëjta është e formës deklarative dhe pretendimet e tyre nuk i mbështesin në prova. Po ashtu e ka kundërshtuar edhe parashtresën e datës 26.05.2022, të parashtruar nga e paditura ku të njëjtit e konfirmojnë legjitimitetin e tyre konkretisht pohojnë se nuk është kontestuese që paditësit kanë lidhur kontratë me Kompaninë “E.” sh.p.k. por punën e tyre apo vend punimin e kanë pasur në spitalin rajonal të Gjakovës “Isa Grezda”. Pretendimi tjetër i palës se paditur se paditësit nuk kanë paraqitur paraprakisht kërkesë tek e paditura, po ashtu nuk qëndron ky fakt, për arsye se paditësit me datë 01.03.2021, kanë paraqitur kërkesë të përbashkët edhe me kolegët e tjerë lidhur me kompensimin e këtyre shtesave(të cilës i kanë bashkangjitur kontratat e punës, listat e pagave, llogarit bankar etj.), me të cilin paditëset kanë kërkuar kompensimin e këtyre shtesave ndaj kësaj kërkesë e paditura nuk ka dhënë përgjigje, andaj edhe janë detyruar që kërkesat e tyre të i realizojnë përmes procedurës gjyqësore, e për këtë arsye vlerëso se padia paraqitur me 1 prill 2021, konkretisht brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e ligjit të punës ku është thirrur e paditura. Ka theksuar se e paditura në parashtresën e saj e ka konfirmuar se përpos zyrtarëve publik ka rimbursuar edhe kompanitë

private për shkak të pandemisë Covid-19, por që në rastin e paditësve nuk e ka bërë një gjë të tillë. Ligjshmërinë e këtyre pagesave e ka konfirmuar edhe raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2020, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të zyrës kombëtare të auditimit, ku në këtë raport po që se do të kishte shkelje në këto pagesa do të përcaktoheshin dhe do të listoheshin në këtë raport, por që nuk ka ndodhur. Duke qenë se Qeveria e Kosovës ka nxjerrë një vendim të tillë atëherë e njëjta e obligon që ti kompensoi të gjitha obligimet që dalin nga ky vendim dhe me këtë rast e paditura e fiton legjitimitetin pasiv për të qenë palë në këtë kontest, pasi e ka pasur për detyrë që këto kërkesa të i realizojë në mënyrë vullnetare. Lidhur me pretendimin e të paditurës, se vendimet e Qeverisë së Kosovës me nr. 06/25 dhe 01/19 nuk e obligojnë të paditurën për të realizuar apo ekzekutuar pagën për paditësit, nuk qëndrojnë për faktin se është dëshmuar se këto dy vendime veçse janë ekzekutuar në tërësi ku janë paguar shtesat mbi pagën bazë të cilat vërtetohen përmes pasqyrave të llogarive bankare. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të marrë Aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesa e saj ashtu që për secilin paditës të iu kompensohen shtesat mbi pagën bazë sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 18/38, ashtu që shtesat të iu paguhen për muajin Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020 me nga 100 euro, pra shumën prej 600 eurosh për secilin paditës me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga momenti i parashtrimit të padisë me datë 1 prill 2021 e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 40.00.-€, për përpilimin e padisë prej 312.00.-€, dhe për përfaqësim në dy seancë gjyqësore nga 405.60.-€ apo në shumën e përgjithshme 1,163.20.-€.

Gjykata në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, e cila me parashtrësën e datës 22.06.2022, e ka njoftuar gjykatën nuk do të marre pjesë në seancë e shqyrtimit kryesorë, duke propozuar që e njëjta të mbahet në mungesë të përfaqësueses së të paditurës.

E paditura Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, përmes përfaqësueses së Avokaturës Shtetërore F. G., në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 18.10.2021, ku ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të palejuar. Të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë. Ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësit kanë krijuar marrëdhënie pune me Kompaninë kontraktuese “E.” sh.p.k., në bazë të Kontratave të Punës që paditësit kanë deponuar si prova në gjykatë. Bazuar në këto kontrata, neni 20 përcakton se “punëdhënësi dhe i punësuar i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me ligj, me Kontratën Kolektive dhe me këtë Kontratë” dhe me këtë konstatohet se Ministrisë së Shëndetësisë i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë, kjo për faktin se paditësit nuk kanë lidhur kontratë pune me të paditurën. Sa i përket Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.18/38 i datës 30.10.2020, ky vendim ka të bëjë vetëm për nëpunësit e institucioneve publike shëndetësore të cilët janë nëpunës të rregullt të institucioneve publike dhe të cilët paguhën përmes sistemit të pagave e jo kategoritë tjera, duke përfshirë edhe kategoritë e paditësve, të cilët kryejnë shërbime përmes kontraktiveve në mes institucioneve dhe kompanive private dhe askush nga kjo kategori

nuk ka përfituar shtesa për këtë periudhë sipas këtij vendimi. E njëjta edhe në parashtrësën e datës 22.06.2022 dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim po me këtë parashtrësë ka theksuar se e kundërshton padinë e paditësve edhe për faktin se paditëses nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të parapara me dispozitat e nenit 78 par.1 dhe 79 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, pasi që nuk kanë paraqitur kërkesë, andaj edhe padia është e paafatshme. Tutje ka theksuar se nuk është kontestuese se e paditura ka përmbushur obligimin ligjor konform vendimeve qeveritare lidhur me pagesat e shtesave pasi që punonjësit kanë aplikuar për këtë të drejtë, me këtë rast paditëset nuk kanë dëshmuar punën e tyre, nuk kanë vërtetuar se e paditura ia ka mohuar të drejtat sipas kërkesëpadisë. Po ashtu e njëjta ka theksuar se e paditura përpos zyrtarëve publik ka rimbursuar edhe kompanitë private për shkak të pandemisë COVID-19. Përfundimisht vendimet qeveritare të të paditurës ku edhe është mbështetur kërkesëpadia, asnjë dispozite e këtyre vendimeve nuk parashohin veprimin retoraktiv që do të realizohej padia lidhur me kompensimin e shtesave. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadi e paditëseve të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontrata e punës për paditësen A. G. e datës 02.07.2020, Pasqyra bankare për paditësen A. G. e lëshuar nga BKT e datës 06.05.2022 me numër K009/730, Kontrata e punës për paditësen A. Ll. e datës 02.07.2020, Pasqyra bankare për paditësen A. Ll. e lëshuar nga BKT e datës 27.05.2022 me numër B009/730, Kontrata e punës për paditësen A. Z. e datës 02.07.2020, Pasqyra bankare, për paditësen A. Z. e lëshuar nga ProCredit Bank e datës 27.05.2022, Kontrata e punës për paditësin B. T. e datës 02.07.2020, Pasqyra bankare për paditësen B. T. e lëshuar nga BPB e datës 30.05.2022 për periudhën qarkulluese 01.01.2020-31.12.2021, Kontrata punës për paditësen B. T. e datës 01.10.2020, Pasqyra bankare për paditësen B. T. e lëshuar nga BKT e datës 22.05.2022, Lista e punëtorëve Kompania “. . .” sh.p.k. për njësinë Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë për muajt periudha Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020, Kërkesa drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me numër të protokollit 05-1385 e datës 01.03.2021, Vendimi me numër 18/38 i datës 30.10.2020, Vendimi numër 01/19 i datës 30.03.2020, Vendimi numër 0625 i datës 17.04.2020, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2020.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,(më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontrata e punës për paditësen A. G. e datës 02.07.2020, gjykata vërteton faktin se paditësja A. G. ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar me . . . sh.p.k., në vendin e punës H. / Sp.Gjakovë. Pasqyra bankare për paditësen A. G. e lëshuar nga BKT e datës 06.05.2022 me numër K009/730, ka vërtetuar rrethanën se paditëses i është paguar shtesa mujore mbi pagën bazë në vlerë prej 256.50 euro, në emër të Covid19- Pako 1.6 të ekzekutuara nga Thesari – Ministria e Financave me datë 23.06.2020.

Nga Kontrata e punës për paditësen A. Ll. e datës 02.07.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A. Ll. ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar me . . . sh.p.k., në vendin e punës H. / Sp.Gjakovë, ndërsa pasqyra bankare e lëshuar nga BKT e datës 27.05.2022 me numër B009/730, gjykata ka vërtetuar faktin se paditëses A. Ll. i është ekzekutuar paga mujore për Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020.

Nga Kontrata e punës për paditësen A. Z. e datës 02.07.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar me . . . sh.p.k., në vendin e punës H. / Sp.Gjakovë. Pasqyra bankare të njëjtën e lëshuar nga ProCredit Bank e datës 27.05.2022, gjykatës i ka vërtetuar faktin se se paditëses i është paguar shtesa mujore mbi pagën bazë në vlerë prej 170.00 euro me datë 05.05.2020 në emër të Covid 19- Pako 1.3, 86.50 euro me datë 22.05.2020 dhe 256.50 euro me datë 19.06.2020, të dyja këto shtesa në emër të Covid 19- Pako 1.6, të gjitha ekzekutuara nga Thesari – Ministria e Financave.

Nga Kontrata e punës për paditësen B. T. e datës 02.07.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja B. T. ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar me . . . sh.p.k., në vendin e punës H. / Sp.Gjakovë. Pasqyra bankare për paditësen B. T. e lëshuar nga BPB e datës 30.05.2022 për periudhën qarkulluese 01.01.2020-31.12.2021, gjykatës i ka vërtetuar faktin se të njëjtës i është paguar shtesa mujore mbi pagën bazë në vlerë prej 170.00 euro me datë 05.05.2020 në emër të Covid 19 - Pako 1.3, 86.50 euro me datë 22.05.2020 dhe 256.50 euro me datë 19.06.2020, të dyja këto shtesa në emër të Covid 19 - Pako 1.6, të gjitha ekzekutuara nga Thesari – Ministria e Financave.

Nga Kontrata punës për paditësen B.h T. e datës 01.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja B.h T. ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar me . . . sh.p.k., në vendin e punës H. / Sp.Gjakovë. Nga Pasqyra bankare për paditësen B.h T. e lëshuar nga BKT e datës 22.05.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditëses B.h T. i është ekzekutuar paga mujore për Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020.

Nga Lista e punëtorëve Kompania “. . .” sh.p.k. për njësinë Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë për muajt periudha Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditëset A. G., A. Ll., A. Z. dhe B. T. kanë punuar në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë në periudhat e lartcekura, kurse paditësja B. T. ka punuar vetëm në muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020.

Nga Kërkesa drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me numër të protokollit 05-1385 e datës 01.03.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. Arbër Guta iu kanë drejtuar me kërkesë të paditurës lidhur me kompensimin e shtesave në paga mujore sipas Vendimit nr.18/38 i datës 30.10.2020.

Nga vendimi numër 01/19 i datës 30.03.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr Vendim ku në pikën 1.6 të këtij vendimi është paraparë sigurimi i shtesës prej 300 euro për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit në punën e tyre si stafi mjekësor (mjekët dhe infermierët)...për muajin Prill dhe Maj.

Nga vendimi numër 06/25 i datës 17.04.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë Vendim ku në pikën 3. të këtij vendimi është përcaktuar se “në pikën I nën-pika 1.6 e Vendimit numër 01/19 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale i datës 30.03.2020, fjalët “stafi mjekësor (mjekët dhe infermierët)”, ndryshohet me fjalët “stafi mjekësor dhe mbështetës (mjekët, infermierët dhe personeli tjetër i ekspozuar rrezikut).

Ne vendimin me numër 18/38 i datës 30.10.2020, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës në pikën 1. të këtij vendimi është paraparë që “për shkak të pandemisë shtesat mujore mbi pagën bazë për personelin aktiv në vend të punës për muajin e plotë për të cilin merret shtesa në institucione shëndetësore publike përmes listës së pagave në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID – 19 për muajin Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, do të jenë si në vijim” (...)1.3.Kategoria III-Staf mbështetës/technik, ju ndahen shtesat prej 100.00-€. në muaj”, ndërsa pika 4 e këtij vendimi ka përcaktuar se “për këtë kategori shtesat paguhen edhe për muajin Korrik dhe Gusht”.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave të lartpërmendura, të cilave iu falë besimin e plotë, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e bazuar. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar është provuar fakti se paditëset kanë lidhur kontrata me afat të caktuar me Kompaninë “. . .” sh.p.k. me seli në Prishtinë, por janë angazhuar në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë si hixhienistë, përkatësisht paditëset A. G., A. Ll., A. Z. dhe B. T. kanë punuar në këtë institucion shëndetësor në muajt Korrik – Dhjetor 2020, kurse paditësja B. T. ka punuar vetëm në muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020, rrethanë kjo e vërtetuar nga lista e punëtorëve pranë kompanisë “. . .” sh.p.k., për njësinë Spitali Rajonal” Isa Grezda” në Gjakovë. Është fakt notor që në periudhat e lartcekura gjatë të cilës paditëset kanë punuar, ka qenë periudhë pandemie dhe lidhur me këtë Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim numër 18/38 i datës 30.10.2020, ka vendosur që stafit mbështetës të institucioneve shëndetësore të iu njohë shtesat mbi pagën mujore në vlerë prej 100.00 euro në muaj, për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, dhe në mënyrë retroaktive për stafin mbështetës edhe për muajt Korrik dhe Gusht 2020. Përkundër kësaj, nga lista e pagave për secilin paditëse, gjykata ka vërtetuar faktin se në asnjërin nga këta muaj këto shtesa nuk janë realizuar nga ana e të paditurës. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëseve nuk iu ka paguar shtesave mujore mbi pagën bazë, të parapara me vendimi e lartcekur të Qeverisë së Kosovës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve është e themeltë, dhe në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë bëri përllogaritjen në atë mënyrë që për muajt Korrik- Dhjetor 2020, ndërsa për paditësen e pestë për muajt Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 e i’u njohu shumat nga 100.00-€ në muaj, duke i’u njohur shumat e përgjithshme si në pikën I, të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se për paditësen B.h T., gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta ka punuar vetëm në muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020, gjë që vërtetohet nga Lista e punëtorëve Kompania “. . .” sh.p.k. për njësinë Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, ndërsa për muajt Korrik, Gusht, Shtator 2020, ku emri i të

njëjtës nuk figuron në listën e muajve Korrik, Gusht dhe Shtator 2020. Po ashtu edhe nga Pasqyra bankare për paditësen për të njëjtën e lëshuar nga BKT e datës 22.05.2022, shihet se e njëjta ka realizuar pagë mujore vetëm për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të autorizuarës të paditurës në lidhje me mungesën e legjitimitetit pasiv të palës së paditur, duke u thirrur në faktin se paditëset nuk kanë lidhur kontratë pune me të paditurën, por gjeti se të njëjtat pretendime janë të pabazuara për arsye se paditëset pavarësisht se kanë lidhur kontratë pune me Kompaninë “. . .” sh.p.k. me seli në Prishtinë, të njëjtit kanë qenë të angazhuar në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë si hixhienistë në periudhat e lartcekura dhe sipas Vendimit 18/38 i datës 30.10.2020 shtesat mujore iu kanë takuar edhe kategorisë së stafit mbështetës/teknik të cilët kanë qenë të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID-19, për periudhën Korrik – Dhjetor 2020. Në të njëjtin vendim, pika 7, është përcaktuar se *“obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi”*, andaj ka qenë detyrë e të paditurës që të i kompensojë shtesat në pagë për paditëset. Sa i përket pretendimit se *“askush nga kjo kategori nuk ka përfituar shtesa për këtë periudhë sipas këtij vendimi”*, gjykata vë në dukje se e njëjta kategori përpara periudhës për të cilën kërkohen shtesat në pagë, u janë paguar shtesat mujore në vlerë totale prej nga 256.50 euro, të gjitha të ekzekutuara nga Thesari – Ministria e Financave, për çka nga Lista e pagave për secilin paditës, gjykata ka vërtetuar faktin se në muajin Prill 2020 paga është ekzekutuar nga . . .sh.p.k., ndërsa shtesa prej 256.50 euro nga Thesari – Ministria e Financave, nga çka rrjedh se pavarësisht faktit se paditëset kanë qenë të kontraktuar nga kompania private e lartcekur, ndërsa kanë punuar në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, shtesat mbi pagën mujore në emër të COVID-19, i kanë marrë nga Thesari i Republikës së Kosovës, andaj nuk qëndron pretendimi se kjo kategori asnjëherë nuk ka përfituar nga shtesat në pagë. Për më tepër vetë e paditura në parashtresën e datës 22.06.2022, ka theksuar se *“përpos zyrtarëve publik, ka rimbursuar edhe kompanitë private për shkak të pandemisë COVID 19”*, por që e paditura nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën vërtetohet se e paditura të ketë përmbushur obligimin sipas vendimit të me numër 18/38 i datës 30.10.2020, të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Pretendimin tjetër të autorizuarës të të paditurës në lidhje me faktin se vendimet qeveritare të së paditurës ku edhe është mbështetur kërkesëpadia, asnjë dispozitë e këtyre vendimeve nuk parashohin veprim retroaktiv që do të realizohet kërkesëpadia lidhur me kompensimin e shtesave, gjykata e refuzoi si të pabazuar, pasi që në rastin konkret paditësve iu është shkëlur e drejta në shtesat në pagë, duke iu shkaktuar edhe dëm, për çka nga dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përkatësisht neni 136 par.1 përcakton se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, andaj në rastin konkret gjykata konsideron se paditësve iu është shkaktuar dëm nga e paditura duke mos u ekzekutuar shtesat në pagë. Njashtu edhe në pikën 4 të vendimit Nr. 18/38 i datës 30.10.2020, i Qeverisë së Republikës së Kosovës është parapara pagesa retroaktive për stafin mbështetës për muajin Korrik dhe Gusht.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e të autorizuarës të të paditurës në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, duke u thirrur në faktin se padia është e pasafatshme, por një pretendim të tillë e refuzoi

duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit nr.03/L-212 të Punës, përkatësisht nenin 78 par.1 ku ka përcaktuar se *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.”*, ndërsa paragrafi 2 ka paraparë që *“Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.”*. Kurse neni 79 ka përcaktuar se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.”*. Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës, ka vërtetuar se paditësit përmes të autorizuarit të tyre avokatit Arbër Guta, me datë 01.03.2021 kanë paraqitur Kërkesë me të cilën iu kanë drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin e shtesave në paga mujore sipas Vendimit nr.18/38 i datës 30.10.2020 dhe meqenëse brenda afatit prej 15 ditësh, të njëjtit nuk kanë marrë asnjë përgjigje, atëherë me datë 01.04.2021 kanë paraqitur padi për kompensimin e shtesave mujore mbi pagën bazë, çka do të thotë se padinë e ka paraqitur pas 30 ditësh, prej momentit të paraqitjes së kërkesës, apo pas 15 ditësh pas kalimit të afatit për përgjigje nga punëdhënësi, pra gjykata erdhi në përfundim se padia është paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën VII të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 1,163.20.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 312.00.-€, si dhe për përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në dy seancë shumë prej nga 405.60.-€ (për dy seanca 811.20.-€), të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7).

Prandaj, gjykata bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv te këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.369/21 me datë 24 qershor 2022

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.